



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 444/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret Muhamet Rexha kryesues, Nenad Laziq, dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Valon Ramadani nga subjektit politik NISMA PER KOSOVEN , dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datën 26.06.2014 për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të datës 08.06.2014, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës –Valon Ramadani nga subjekti politik NISMA PER KOSOVEN, dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Valon Ramadani të subjektit politik Nisma Për Kosovën me nr.55 në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit ka konstatuar se ka fituar 4 vota, por nga votat e fituara ju kanë shënuar vetëm 2 në FRK. Pretenduesi i ankesës thekson se ky gabim ka ndodhë në VV.0713D/03D, dhe kërkon që ky gabim të përmisohet që sipas tij figuron edhe në rezultatin final të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e vëzhguesit të VV 0713D/03D- dhe kopjen e FRK-së.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme* “

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati për deputet- Valon Ramadani me nr. 55 të subjektit politik Nisma Për Kosovën në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për votat e munguara të kandidatit në fjalë për të cilën pretendohet në ankesën e tij se i mungojnë votat e fituara në vendvotimin 0713D/03D.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 0713D/03D për Komunën e Ferizajt e cila kuti ka qenë e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shirit në mes të kutisë. Shiritat anësor të sigurisë kanë numrin 115873, 115872, 115874 dhe 115875, ndërsa shiriti i mesëm me numër 115880 nuk është prekur fare. Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit kishte numrin 115878. Po ashtu konstatohet mbyllja e thesit brenda kutisë me shirit të sigurisë me numër 0010670 dhe mbyllja kutisë së votimit me shiritat të sigurisë me numra 0010666, 0010667, 0010668 dhe 010669, ndërsa shiriti i mesëm nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me nr.55 nga radhët e subjektit politik Nisma Për Kosovën i posedon 2 vota e jo siç ka pretenduar në ankesën e tij se i ka 4 te cilat iu janë shënuar në FRK. Poashtu, pas numërimit të votave të subjektit politik Nisma Për Kosovën vetëm sa i përket kandidatit në fjalë, lidhur me VV 0713D/03D, del se po të njëjtin numër të votave e posedon.

Lidhur me pretendimin ankimor të kandidatit për deputet Valon Ramadani nga subjekti politik-Nisma Për Kosovën ,se gjatë numërimit të votave në VV 0713D/03D nuk ju kanë shënuar votat nuk qëndron sepse pas hetimit të bërë , është vërtetuar se votat e tij në FRK ekzistojnë dhe pas rinumërimit të njëjtat rezultojnë edhe në kutinë e votimit siç janë shënuar edhe në FRK lidhur me këtë vendvotim.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 444/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexhë.**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*